



Le të jetë gjuha jote gjithnjë e njomë nga përmendja e Allahut të Madhërishëm

Abdullah ibën Busri (Allahu qoftë i kënaqu me të!) tregon: "Një njeri vajti te Profeti ﷺ dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, ligjet e Islamit janë bërë shumë, ndaj më trego ndonjë çështje përmbledhëse, që të kapem pas saj!" Ai tha: "Le të jetë gjuha jote gjithnjë e njomë nga përmendja e Allahut të Madhërishëm."

[Sahih] [Transmetojnë Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ahmedi]

Një njeri iu ankua Profetit ﷺ se adhurimet vullnetare ishin shtuar aq shumë, sa që ai nuk mund t'i përballonte për shkak të dobësisë së tij. Pastaj e pyeti Profetin ﷺ që t'i tregonte një vepër të lehtë, e cila sjell shpërblim të madh dhe tek e cila ai mund të kapet fort. Atëherë Profeti ﷺ e udhëzoi që gjuha e tij të jetë e freskët dhe në lëvizje të vazhdueshme në përkujtimin e Allahut të Lartësuar në çdo kohë dhe gjendje, qoftë me tesbih (duke thënë: subhanallah), tahmid (duke thënë: elhamdulillah), istigfar (duke thënë: estagfirullah), si dhe lutje dhe gjëra të tjera të ngjashme.

<https://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4716>

